



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 547 Prot.

Tiranë, më 21.01.2025

URDHËR

Nr. 36, Datë 21.01.2025

PËR

DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 413, DATË 26.07.2019 “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR APLIKIMIN, PROCEDURAT, AFATET DHE DOKUMENTACIONIN PËR TU BËRË PJESË E REGJISTRIT SHTETËROR TË MËSUESVE TË GJUHËS SHQIPE E TË KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË”, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 11, nenit 26 dhe pikës 5, të nenit 49 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 5 të vendimit nr. 104, datë 28.2.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë” dhe urdhrin nr. 609, datë 20.12.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 413, datë 26.07.2019 “Për përcaktimin e rregullave për aplikimin, procedurat, afatet dhe dokumentacionin për tu bërë pjesë e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:
 - a) Pikat 3, 5 dhe 6 ndryshojnë si më poshtë:

“3. Mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë (më poshtë kandidatët) që dëshirojnë të bëhen pjesë e regjistrit shtetëror duhet të aplikojnë dhe ngarkojnë dokumentacionin në portalin unik qeveritar “e-Albania”, nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Parauniversitar (SMIP), brenda afateve të përcaktuara.

...

5. Lista e kandidatëve aplikues bëhet e ditur në faqen zyrtare të ASCAP.

6. Kandidati plotëson formularin e aplikimit në portalin unik qeveritar “e-Albania”, i cili shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë:

 - a) Kopje e skanuar e dokumentit të identifikimit (nëse është me shtetësi të huaj);

- b) kopje e skanuar e licencës së mësuesisë e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar;
- c) kopje e skanuar e diplomës/ve të të dy cikleve të studimit, në fushën e mësuesisë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar dhe librezë e punës që vërteton ushtrimin e profesionit përpara datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- c) kopje e skanuar e certifikatave dhe e kualifikimeve si mësues të gjuhës shqipe, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë ose në vende të tjera (nëse kanë);
- d) dokument i skanuar që vërteton që kandidati jep mësim në gjuhën shqipe, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar (të saktësohet nëse është institucion publik ose privat, nëse është punë me kohë të plotë ose të pjesshme), me përjashtim të rasteve kur ky dokument lëshohet nga përfaqësitë diplomatike."

b) Shkronjat "b" dhe "c" të pikës 7 ndryshojnë si më poshtë:

"b) njofton kandidatët nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania" për dokumentet shtesë që mund të duhen, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e aplikimit. Kandidati plotëson dokumentacionin brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga njoftimi për plotësim dhe e dërgon nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania".

c) njofton kandidatët që plotësojnë kushtet për t'u bërë pjesë e regjistrit shtetëror, si dhe ata që nuk plotësojnë kushtet për t'u pjesë e tij, duke dhënë argumentet përkatëse të mospranimit, nëpërmjet portalit unik qeveritar "e-Albania"

c) Pas pikës 10 shtohet pika 11 me përmbajtje si më poshtë:

"11. Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ministria përgjegjëse për arsimin, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij urdhri, në kohën e paraqitjes së tyre."

d) Shtojca nr. 1 e urdhrin shfuqizohet.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI

